



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

Data 25.3.2023  
Nr. Prot 1961

**KËRKUES:** KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**OBJEKTI:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrative

**DREJTUAR:** KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë denoncime për organizimin e 20 (njëzetë) veprimtarive publike, nga 10 (dhjetë) institucione publike, për shkelje administrative në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator nga kryetar bashkie dhe persona përgjegjës që kanë detyrim për raportim të veprimtarive publike.

Denoncimet dhe indiciet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**1- Bashkia Fier, ka administruar denoncime regjistruar me nr. 40, 41, 127 ID, për të cilën pretendohet si vijon:**

- *"Bashkia Fier ka raportuar si aktivitet të institucionit në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së aktivitetin e planifikuar për t'u zhvilluar në datën 28 Janar 2023, sipas përshkrimit të të cilit "Komuniteti i Njesisë Administrative Dermenas ka paraqitur pranë njesisë një kërkesë me shkrim, ku ka kërkuar një takim me kryetarin e bashkisë".*

*Në takimin e zhvilluar ka marrë pjesë edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste në Qarkun Fier, i zgjedhur deputet në Qarkun e Elbasanit, z. Taulant Balla. Në përmbajtje të fjalimit të tij, u konstatuan lehtësisht dhe haptazi thirrje që e bënë këtë aktivitet me natyrë elektorale...".*

*Video e aktivitetit gjendet e postuar në Faqen Zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Fier, z. Armando Subashi (<https://www.facebook.com/ëatch/armandosubashi.al/>), në linkun: <https://www.facebook.com/armandosubashi.al/videos/898967471136975/>.*

*Ky aktivitet është transmetuar të paktën nga dy media audiovizive, konkretisht nga:*

*Vizion Plus TV:*

*<https://www.vizionplus.tv/balla-bujqesia-motor-i-zhvillimit-te-fierit-saliu-shqetesohet-per-hallet-e-veta-21-janarin-dhe-gerdecin/>;*

*TvKombi:*

<https://tvkombi.com/42619Ki2/?fbclid=IeAROM7eMosT35p3PLRëMLIIfOSwetO2hG9H3tLbRVqEn4WZq2Vd2upNLjIU>

*Balla: Bujqësia motor i zhvillimit të Fierit. Saliu shqetësohet për hallet e veta, 21 Janarin dhe Gerdecin-TV Komb.*

*Bazuar në gjithë sa më sipër, aktiviteti është haptas elektorale dhe përbën shpërdorim të burimeve publike në fushatën zgjedhore, pasi është përdorur një aktivitet zyrtar i Bashkisë Fier për propagandë elektorale.”*

- *“Bashkia Fier ka raportuar si aktivitet të institucionit në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së aktivitetin e planifikuar për t’u zhvilluar në datën 28 Janar 2023, sipas përshkrimit të të cilit deklarohet se “Komuniteti i Njesisë Administrative Topojë ka paraqitur një kërkesë pranë njesisë, ku ka kërkuar një takim me kryetarin e bashkisë për t’u njohur nga afër me investimet që janë parashikuar të bëhen në zonën e tyre nga Bashkia Fier gjate vitit 2023”.*

*Në aktivitet, përpos të tjerëve, kanë marrë pjesë dhe folur për pjesëmarrësit, z. Taulant Balla dhe z. Petro Koçi, deputetë të Partisë Socialiste. Në përmbajtje të fjalimit të tyre, u konstatuan lehtësisht dhe haptazi thirrje që e bëjnë këtë aktivitet me natyrë elektorale.*

*Video e aktivitetit gjendet e postuar në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Fier, z. Armando Subashi, në link:*

<https://www.facebook.com/armandosubashi.al/videos/717703839822188>.

*Aktiviteti është transmetuar gjithashtu, të paktën edhe nga një media, TV Kombi:*

<https://tvkombi.com/kryebashkiaku-i-fierit-armando-subashi-ka-garantuar-banoret-e-njesise-administrative-te-topojes-per-te-vazhduar-punen-e-nisur-edhe-ne-vijim-balla-bashkia-e-fierit-modeli-si-punohet-ne-te-gjithe-shqi2/?fbclid=IeAR3PULHRz6cJ39E5EFHsëNggËëCysMqp5yMC89Orl-2yHXsHkZkKyO7ë-ZY>.

<https://tvkombi.com/balla-nga-topoja-halli-i-saliut-eshte-drejtësia-14-maji-eshte-goditja-perfundimtare-ge-ne-duhet-tu-japim-sali-berishes-dhe-ilir-metes/>.”

- *“Bashkia Fier ka raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, zhvillimin e një aktiviteti me temë “Tryezë diskutimi me komunitetin”, në këtë link: <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/01/31/tryeze-diskutimi-me-komunitetin>”.*

*Aktiviteti është raportuar nga bashkia Fier në datën 31.1.2023, dhe është planifikuar për t’u zhvilluar në datën 4.2.2023. Nga konsultimi i faqeve në mediat sociale vërehet se ky aktivitet nuk është pasqyruar si i zhvilluar në datën e planifikuar. Ndërkohë, një aktivitet me të njëjtat të dhëna dhe në të njëjtin vend është publikuar në mediat sociale të kryetarit të bashkisë Fier z. Armando Subashi, drejtuesit politik të qarkut Fier z. Taulant Balla, si dhe nga media lokale TV Kombi në datën 19.2.2023. Në rast se aktiviteti i datës 4 Shkurt 2023, është zhvilluar, pavarësisht se për atë nuk ka patur asnjë postim apo jehonë mediatike, sikurse është praktikë e aktivitetëve të kësaj bashkie, atëherë aktiviteti i datës 19 Shkurt 2023, përpos se evidentohet me përmbajtje dhe natyrë elektorale, rezulton të jetë edhe një aktivitet i paraportuar.*

*Postimi i videos së bërë në faqen zyrtare të kryetarit të bashkisë Fier z. Armando Subashi, më datën 19.02.2023, si përshkrim të saj dhe të aktivitetit të zhvilluar, ka përmbajtjen e mëposhtme: “ME*

NJERËZIT PËR NJERËZIT”.

Mbrostar, Fier “Ne do të vijojmë me projektet e rëndësishme infrastrukturore në bashkinë e Fierit falë mbështetjes së qeverisë @Edi Rama Sondazhet konfirmojnë një fitore shumë të thellë tonën #14Maj2023 . Nga ana tjetër Aleanca e Rublave Berisha-Meta do të vazhdojnë protestat kundër drejtësisë për interesat e tyre personale. Por siç thotë populli "Qentë le të lehin, karvani shkon përpara". Na duhet që të gjithë sëbashku të vijojmë me punën dhe të realizojmë çdo premtim të dhënë për banorët e Mbrostarit dhe të Fierit, me një fokus të veçantë

#BUJQËSIA

#TëBashkuarJoTëNdarë

#ShqipëriaEArdhmjaJonë

#SkaKohëPërPushim

Përpos këtyre postimeve, edhe në median lokale TV Kombi është pasqyruar lajmi i takimit ku, ndër të tjera evidentohet qartë mesazhi elektorale që përçohet.”

Me shkresën nr. 757 prot. datë 20.2.2023, bashkisë Fier i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e parë dhe nëpërmjet shkresës nr. 1395/1 prot., datë 17.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 757/1 prot., datë 20.2.2023, jemi informuar nga bashkia Fier se:

“Bashkia Fier ka kryer raportimin e aktivitetit të datës 28 Janar 2023, në Dërmenas me komunitetin e zonës për problematikat dhe njohjen konkretisht të komunitetit me investimet e parashikuara për t'u bërë me buxhetin e bashkisë gjatë vitit 2023 për zonën e tyre. Raportimi është bërë duke respektuar afatet. Në raportim është shprehur qartë në lidhje me tematikën që do të trajtohej si edhe pjesëmarrja e mundshme në takim. Ai është saktësuar i hapur për publikun, duke mos penguar asnjë pjesëmarrje të vullnetshme nga të gjitha instancat apo përkatësisë politike, sociale, fetare, gjinie etj. Në këtë kontekst nuk mund të pengohej as prezenca e Deputetit të Parlamentit Shqiptar Taulant Balla. Duke respektuar pozicionin si deputet i Parlamentit Shqiptar, z. Balla ka shprehur dëshirën për të folur, gjë që nuk mund të pengohej kjo e drejtë fjale, ashtu siç nuk u pengua asnjë prej pjesëmarrësve në takim për të folur. Përsa i përket përmbajtjes së fjalës së z. Balla, kjo nuk është përgjegjësi që mund t'i atribuohet organizatorëve të këtij takimi të kërkuar nga vet komuniteti dhe as Kryetarit të Bashkisë Fier. Në fjalën e kryetarit të bashkisë nuk ka patur asnjë moment thirrje ose shprehje me karakter politik përveç reflektimit të investimeve që janë përcaktuar në buxhetin e vitit 2023, nga Bashkia Fier dhe diskutimin me komunitetin mbi problematikat e hasura prej tyre. Ashtu siç është raportuar nga bashkia Fier, në këtë takim nuk ka patur prezencë të medias, por ka qenë vetëm stafi PR i bashkisë Fier dhe i Deputetit Taulant Balla, i cili e shoqëron në çdo lëvizje me qëllim pasqyrimin e takimit në rrjetet e tyre sociale në kuadër të transparencës me publikun. Përsa i përket pasqyrimin në mediat e cituara duam të theksojmë se materialet janë marrë (kopjuar) prej tyre pikërisht nga këto pasqyrime në rrjete sociale (nuk është dërguar asnjë material filmik ose dokument shkresor). Asnjë prej tyre nuk ka qenë prezent në takim.”

Me shkresën nr. 758 prot. datë 10.2.2023, bashkisë Fier i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e dytë dhe nëpërmjet shkresës nr. 1398/1 prot., datë 17.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 758/1 prot., datë 20.2.2023, jemi informuar nga bashkia Fier se:

“Bashkia Fier ka kryer raportimin e aktivitetit në datën 28 Janar 2023 në Topojë me komunitetin e zonës për problematikat dhe njohjen konkretisht të komunitetit me investimet e parashikuara për t'u realizuar me buxhetin e bashkisë gjatë vitit 2023 për zonën e tyre. Raportimi është bërë duke respektuar afatet dhe është shprehur qartë në lidhje me tematikën që do të trajtohej. Në këtë raportim është shprehur qartë edhe



*pjesëmarrja e mundshme në takim e Deputetëve të Parlamentit Shqiptar, i cili është saktësuar si i hapur për publikun duke mos penguar asnjë pjesëmarrje me dëshirë nga të gjitha instancat apo përkatësisë politike, sociale, fetare, gjinie etj. Në këtë kontekst nuk mund të pengohet as prezenca e Deputetëve të Parlamentit Shqiptar z. Taulant Balla dhe z. Petro Koçi. Duke respektuar pozicionin si deputetë të Parlamentit Shqiptar, z. Balla dhe z. Koçi, kanë shprehur dëshirën për të folur. E drejta e fjalës nuk mund të pengohet, sikurse nuk i'u pengua kjo e drejtë asnjë prej pjesëmarrësve në këtë takim. Përsa i përket përmbajtjes së fjalës së tyre, kjo nuk është përgjegjësi që mund t'i atribuohet organizatorëve të këtij takimi të kërkuar nga vet komuniteti dhe as Kryetarit të Bashkisë Fier. Në fjalën e Kryetarit të Bashkisë nuk ka patur asnjë moment thirrje ose shprehje me karakter politik përveç reflektimit të investimeve që janë përcaktuar në buxhetin e vitit 2023 nga Bashkia Fier dhe diskutimin me komunitetin mbi problematikat e hasura prej tyre. Ashtu siç është raportuar nga Bashkia Fier, në këtë takim nuk ka patur prezencë të medias, por ka qenë vetëm stafi PR i Bashkisë Fier dhe i Deputetit Taulant Balla, i cili e shoqëron në cdo lëvizje me qëllim pasqyrimin e takimit në rrjetet e tyre sociale në kuadër të transparencës me publikun. Përsa i përket pasqyrimin në mediat e cituara duam të theksojmë se materialet janë marrë (kopjuar) prej tyre pikërisht nga këto pasqyrimet në rrjete sociale (nuk është dërguar asnjë material filmik ose dokument shkresor). Asnjë prej tyre nuk ka qenë prezent në takim.”*

Nëpërmjet e-mail të datës 27.02.2023, i është kërkuar bashkisë Fier informacion në lidhje me denoncimin e tretë dhe nëpërmjet e-mail 03.02.2023, jemi informuar nga bashkia Fier se:

*“Aktiviteti nuk është pasqyruar në ditën që është zhvilluar dhe është i njëjtë me atë të raportuar të datës 4 Shkurt 2023 dhe në atë datë është bërë, pavarësisht se është publikuar shumë ditë më pas. Duke qenë se gjatë kësaj periudhe në territorin e Bashkisë Fier është e vazhdueshme prezenca e deputetit të Parlamentit z. Taulant Balla, ai është bërë pjesë e axhendës tonë në terren për të qenë prezent në përballjen me komunitetin për të parë nga afër produktin e qeverisjes vendore në raport me shërbimet, investimet dhe matshmërinë e kënaqësisë qytetare ndaj kësaj qeverisjeje si një mision që e ka çdokush dhe akoma më shumë një deputet që është zëri i qytetarëve në Parlament.*

*Ashtu sikurse kemi raportuar, në takim nuk ka patur prani të medias edhe për këtë fakt që ne i publikojmë aktivitetet sipas hapësirave dhe qëllimi ynë nuk është promovimi apo reklama, por shërbimi ndaj qytetarëve dhe prezenca sa më shumë pranë tyre për të ndjekur problematikat dhe i njohur me investimet për vitin 2023 nga buxheti i bashkisë. Kjo është një praktikë e Bashkisë Fier, e cila prej vitesh e ka në praktikën e saj të punës përballjen me qytetarët. TV Kombi, prej disa vitesh nuk funksionon më si një media televizive, por është kthyer thjesht në një rrjet social, i cili furnizohet me lajme nga e gjithë vendi e bota. Ky rrjet social i ka marrë materialet pas publikimeve të bëra në rrjetet tona sociale, ashtu sic mund t'i marrë kushdo.*

*Përsa i përket fjalës së Kryetarit të bashkisë në takim përball komunitetit, ju bëjmë me dije se nuk ka patur asnjë moment që është shprehur politikisht. Ka ruajtur pozicionin e tij të Kryetarit të Bashkisë Fier, ka folur dhe diskutuar me komunitetin vetëm për investimet, problematikat e zonës, kurse në fjalën e Deputetit Balla nuk mund të kemi aksesin e ndërhyrjes apo ndërprerjes. Në lidhje me prerjet e fjalës ka qenë për efekt kohe se nuk mund të transmetojmë në rrjet social gjithë takimin, pasi qëllimi i çdo publikimi është ndjekja dhe nga studimet e faqeve dhe strategjive të ndjekjes nevojitet më pak minutazh. Është thjesht një çështje teknike dhe strategji ndjekshmërie. Ky aktivitet nuk është publikuar në faqen zyrtare të institucionit por në faqen personale të Armando Subashit.”*

Në vazhdim të hetimit të administrativ, është zhvilluar seanca publike e datës 8.3.2023, ku përfaqësuesi i



bashkisë Fier, ka deklaruar se:

*“Referuar denoncimit të tretë, aktiviteti publik është raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 31.01.2023 dhe është zhvilluar më datë 04.2.2023, ditë të shtunë, në ambientet e një biznesi privat, pa media. Është deklaruar se pjesëmarrja është e hapur për çdo deputet të qarkut Fier. Në takim ka marrë pjesë z. Balla, që përveçse deputet i Kuvendit, ka dhe detyrë specifike të ngarkuar nga Partia Socialiste për qarkun Fier. Përsa i përket mediatizimit, në datën 19.2.2023, është publikuar tek faqja Facebook e kryetarit të bashkisë, dhe është shpërndarë edhe nga z. Taulant Balla. Pavarësisht se fjala e kryetarit ka qenë korrekt dhe është folur për ato çfarë ka kërkuar komuniteti dhe problematikat e komunitetit, ajo nuk është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Në fjalën e kryetarit të bashkisë, nuk ka promovim investimesh dhe as ka premtime, vetëm falenderim për pjesëmarrësit si dhe shprehja “që ka akoma shumë për të bërë”. Referuar fjalës së z. Balla, për shkaqe etike nuk i është ndërprerë fjala dhe as nuk i është tërhequr vërejtje. Pranohet nga përfaqësuesi se fjala e z. Balla mund ti ketë dhënë aktivitetit konotacion politik”.*

Aktivitetet publike të kryera nga bashkia Fier, rezultojnë të jenë raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Referuar të dhënave në deklaruara në ndërfaqen e raportimeve, këto aktivitete nuk përbëjnë veprimtari të ndaluara, në kuptim të nenit 3, të vendimit, nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Megjithatë, gjatë zhvillimit të takimeve ka pasur pjesëmarrje të deputetëve z. Balla dhe z. Koçi, të cilët kanë qenë edhe folës në takimet e organizuara nga bashkia Fier.

Pjesëmarrja e deputetit të zonës apo e funksionarëve politike jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektorale.

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, “Statusi i Deputetit”, deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike që ka me gjithë organet qendrore dhe vendore në vend. Pjesëmarrja e tij në aktivitetet e organizuara nga kryetari i bashkisë nuk e kthen aktivitetin domosdoshmërisht në një takim elektorale. Si pjesë e detyrave funksionale të tij, deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë. Megjithatë, këto takime nuk duhet të shfrytëzohen për kryerjen e thirrjeve elektorale apo përcjelljen e mesazheve me përmbajtje të tillë.

Të ndodhur në kushtet që jemi në periudhë zgjedhore, të gjithë aktorët politikë dhe drejtuesit e organeve publike duhet të tregojnë kujdes të shtuar në përdorimin e fjalimeve me përmbajtje elektorale, në takimet e organizuara në përmbushje të funksioneve të tyre. Kryetari i bashkisë Fier, si organizator i takimeve të mësipërme ka pasur detyrimin për të përcaktuar “objektin dhe tematikën e diskutimit” për folësit në takim.

Në kthimin e përgjigjeve të dërguara shkresërisht dhe nëpërmjet e-mail, z. Subashi pretendon se “Përsa i përket përmbajtjes së fjalës së pjesëmarrësve, kjo nuk është përgjegjësi që mund t'i atribuohet organizatorëve të këtij takimi pasi nuk mund të kemi aksesin e ndërhyrjes apo ndërprerjes”. Neni 91, i Kodit Zgjedhor, ndalon përdorimin e çdo burimi publik në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Drejtuesi i institucionit organizator, si person i ngarkuar me detyra, i lind detyrimi, që në rastet kur ai vëren se folësi ka tejkalluar qëllimin për të cilin është mbledhur, ta ndalojë atë. Në rastet kur të ftuarit ose folësit, në fjalimet e tyre kanë thirrje me përmbajtje partiake ose zgjedhore në favor të një subjekti zgjedhor apo të një kandidati dhe dalin përtej objektit dhe tematikës së takimit, organizatorit të

aktivitetit i lind detyrimi të marrë gjithë masat e nevojshme.

Kryetari i bashkisë Fier, gjatë hetimit administrativ, nuk arriti të provojë objektivisht se, pavarësisht masave të marra nga ana e tij, nuk ka mundur të ndalojë përdorimin e thirrjeve me përmbajtje elektorale nga ana e pjesëmarrësve.

**2- Bashkia Prrenjas**, ka kryer 1 (një) veprimtari publike, regjistruar me nr. **128 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 128 ID *“Bashkia Prrenjas më datë 20.2.23, ka zhvilluar një veprimtari publike të paraportuar në ndërfaqen e KQZ-së. Pjesëmarrës kanë qenë z. Damian Gjijnuri. Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike është postuar në faqen zyrtare të kryetarit të bashkisë Prrenjas, z. Nuri Belba: <https://www.facebook.com/n.belba> dhe ka këtë përmbajtje: “Së bashku me Damianin bashkëbiseduam me pensionistë dhe veteran të Prrenjasit. Qeveria ka treguar vëmendje të veçantë ndaj moshës së tretë duke ofruar përkujdesje dhe mbështetje jo vetëm për shpërblimin e fundvitit por edhe me bonusin e Pakos së Madhe.*

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=640518391413950&set=pcb.640519101413879;>

<https://www.facebook.com/profile.php?id=100064965812711>

*Aktiviteti është pasqyruar në media, ku janë evidentuar qartazi edhe thirrjet e drejtpërdrejta elektorale nga të dy zyrtarë, kryetari i bashkisë z. Nuri Belba dhe nga Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan z. Damian Gjijnuri. Kryebashkiaku Nuri Belba deklaroi se: “...qyteti brenda 4 viteve ishte transformuar duke njohur investime të rëndësishme falë dhe mbështetjes së qeverisë socialiste...”.*

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Prrenjas, nëpërmjet shkresës nr. 624 prot., datë 28.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1214 prot., datë 1.3.2023, ka sqaruar se: *“Aktiviteti është zhvilluar në datë 17.02.2023 dhe është njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e KQZ-së...”.*

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Prrenjas, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 8.3.2023, por nuk pati përfaqësues për bashkinë Prrenjas.

Pasi u njoha me të gjitha faktet dhe rrethanat, rezultoi se nga verifikimet e bëra në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kjo veprimtari është raportuar në datën 12.2.2023. Përsa i përket pjesëmarrjes së z. Gjijnuri në këtë veprimtari duhet të sqarohet se referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8550, datë 18.11.199, “Statusi i Deputetit”, deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike, që ka me gjithë organet qendrore dhe vendore në vend. Pjesëmarrja e tij në aktivitetet e organizuara nga kryetari i bashkisë nuk e kthen aktivitetin domosdoshmërisht në një takim elektorale. Si pjesë e detyrave funksionale të tij, deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë. Megjithatë, këto takime nuk duhet të shfrytëzohen për kryerjen e thirrjeve elektorale apo përcjelljen e mesazheve me përmbajtje të tillë. Të ndodhur në kushtet ku jemi në periudhë zgjedhore kryetarit të bashkisë, si organizator të takimeve të mësipërme kanë pasur detyrimin për të përcaktuar “objektin dhe tematikën e diskutimit” për folësit në takim.

Neni 91 i Kodit Zgjedhor, ndalon përdorimin e çdo burimi publik në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Takimi i kryer nga z. Belba dhe z. Gjijnuri ka pasur përmbajtje elektorale, duke e kthyer aktivitetin në



përmbushje të detyrave institucionale të bashkisë Prrenjas, në një takim elektorale. Përsa më sipër, kryetari i bashkisë Prrenjas, nëpërmjet lejitimit të mbajtjes së fjalimit me përmbajtje elektorale ka përdorur burime publike të organit që ai drejton, në dispozicion të fushatës elektorale.

**3- Bashkia Librazhd, ka kryer 1 (një) veprimtari publike, regjistruar me nr. 4 ID, për të cilën pretendohet si vijon:**

- Denoncimi **nr. 4 ID** *"Bashkia Librazhd ka raportuar fillimisht, në datën 16.01.2023, në ndërfaqe <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/01/16/takim-me-pensionistet/> dhe më pas ka zhvilluar një aktivitet publik në datën 18.01.2023 me temë "Takim me pensionistët" Në këtë takim ka marrë pjesë z. Damian Gjikhuri. Aktiviteti është pasqyruar në disa media, një prej të cilave televizioni kombëtar Klan TV (e gjeni në këtë link <https://tvklan.al/gjikhuri-takim-me-pensionistet-e-librazhdit-ps-vevendje-per-adresimin-e-nevojave-te-moshes-se-trete/>). Në fjalën e mbajtur prej tij z. Gjikhuri ka bërë qartas fushatë elektorale, duke thënë shprehimisht: "Zgjedhjet duam t'i fitojmë, jo thjesht për të mbajtur flamurin e pushtetit sepse Partia Socialiste ka fituar gjithmonë në Librazhd. Qeveri - bashki të jemi një...".*

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Librazhd, nëpërmjet shkresës nr. 534/1 prot. datë 31.1.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 436/1 prot., datë 2.2.2023, ka sqaruar se: *"Aktiviteti është kryer në datën 18.01.2023 në orën 10:00 tema e këtij aktiviteti ka qënë "Bashkebisim me pensionistet mbi bonusin e Pakos se Madhe dhe shpërblimit të fundvitit. "Pjesëmarrja në këtë aktivitet ka qënë vetëm pensionistë të bashkisë Librazhd. Nga ana e bashkisë është bërë publikimi vetëm në faqen e facebook. Kryetari i bashkisë ka përmbushur detyrën e tij funksionale dhe në asnjë moment në fjalimin e tij nuk ka bere thirrje me përmbajtje partiake ose zgjedhore apo shprehje që të kenë natyrë elektorale."*

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Librazhd, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 8.3.2023, por nuk pati përfaqësues të tij.

Pasi u njoha me të gjitha faktet dhe rrethanat, rezultoi se nga verifikimet e bëra në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kjo veprimtari është raportuar në datën 12.2.2023. Përsa i përket pjesëmarrjes së z. Gjikhuri në këtë veprimtari duhet të sqarohet se referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8550, datë 18.11.199, "Statusi i Deputetit", deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike, që ka me gjithë organet qendrore dhe vendore në vend. Pjesëmarrja e tij në aktivitetet e organizuara nga kryetari i bashkisë nuk e kthen aktivitetin domosdoshmërisht në një takim elektorale. Si pjesë e detyrave funksionale të tij, deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë. Megjithatë, këto takime nuk duhet të shfrytëzohen për kryerjen e thirrjeve elektorale apo përcjelljen e mesazheve me përmbajtje të tillë. Të ndodhur në kushtet ku jemi në periudhë zgjedhore kryetarit të bashkisë, si organizator të takimeve të mësipërme kanë pasur detyrimin për të përcaktuar "objektin dhe tematikën e diskutimit" për folësit në takim.

Neni 91, i Kodit Zgjedhor, ndalon përdorimin e çdo burimi publik në mbështetje subjekteve zgjedhore. Drejtuesi i institucionit organizator, si person i ngarkuar me detyra, i lind që në rastet kur të ftuarit ose folësit, në fjalimet e tyre kanë thirrje me përmbajtje partiake ose zgjedhore në favor të një subjekti zgjedhor apo të një kandidati dhe e tejkalojnë objektin dhe tematikën e takimit, organizatorit të aktivitetit i lind detyrimi të marrë gjithë masat e nevojshme.

Gjatë hetimit administrativ, nuk u arriti të provohej objektivisht se, pavarësisht masave të marra nga ana e subjekteve të denoncuara, nuk ka qënë e mundur të ndalohej përdorimi i thirrjeve me përmbajtje elektorale



nga ana e pjesëmarrësve. Përsa më sipër, kryetari i bashkisë Librazhd, nëpërmjet lejimit të mbajtjes së fjalimit me përmbajtje elektorale të z. Gjijnuri, ka përdorur postin e tij, duke vënë në dispozicion të fushtaës elektorale organin që ai drejton, duke shkelur kështu detyrimet që përcakton neni 91 i Kodit Zgjedhor.

**4- Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publikë regjistruar me nr. 64 ID, për të cilën pretendohet si vijon:**

Denoncimi nr. 64 ID *"Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Odise Kote ishte organizator dhe pjesë e dëgjesës publike të zhvilluar në ambientet e Universitetit "Eqrem Çabej" për rritjen e shkallës së mbrojtjes të Lumit Vjosa - Park Kombëtar"*.

Prova link: <https://www.facebook.com/photo/?fbid=555644943258591&set=pcb.555645396591879>

Më datë 13.2.2023, Prefektit të Qarkut Gjirokastrë i është kërkuar informacion nëpërmjet adresës elektronike ku jemi informuar se takimi është organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe i është njoftuar prefektit të qarkut me shkresë nr. 307/3, datë 20.01.2023. Në vijim të hetimit administrativ, më datë 17.2.2023 i është kërkuar informacion Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku jemi njoftuar se e-maili juaj është përcjellë për dijeni Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe së shpejti do të keni një përgjigje nga kjo e fundit, lidhur me të dhënat e kërkuara nga ana juaj".

Më datë 24.2.2023 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura sqaron dhe ndër të tjera bën me dije se *"aktiviteti u zhvillua në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, në datë 30 Janar 2023, ora 11:00, ku ishin të ftuar Prefekti i Vlorës dhe Gjirokastrës, grupet e interesit, institucionet akademike e shkencore në vend, komuniteti i zonës dhe pronarët privatë nëse prona e tyre do të përfshihet në zonën e mbrojtur, që u organizua nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura..."*.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.3.2023, ku të pranishëm ishin përfaqësuesi i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë dhe përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Në seancë u deklarua nga përfaqësuesi i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë se aktiviteti është organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Duke mos qenë një institucion organizator nuk është parë e arsyeshme raportimi nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë. Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, sqaroi se takim është në vazhdimësi të disa takimeve që ka bërë Ministria dhe Agjencia në kuadër të shpalljes së Vjosës Park Kombëtar. Ky takim është organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Përfaqësuesi ka deklaruar se institucioni ka patur problem me aksesimin e ndërfaqes së raportimeve. Referuar shkresës së dërguar nga ana e KQZ-së që në dhjetor për caktimin e personit të kontaktit, institucioni është pajisur me kredencialet nga KQZ-ja vetëm në datën 21.2.2023..."

Përsa më sipër, në referim të provave të disponuara, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë nuk rezulton të jetë organizatori i këtij aktiviteti dhe për këto arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos pushimin e procedimit administrativ ndaj personit përgjegjës të këtij institucioni.





Referuar dokumentacionit të disponuar nëpërmjet e-mail dhe në seancë publike, detyrimi për raportimin e kësaj veprimtarie publike e ka pasur Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Pas verifikimit të rrethanave dhe fakteve, si dhe pas njohjes me pretendimet përfaqësuesit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, vlerësoj se problematikat me sistemin si dhe vonesat me pajisjen me kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi, për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Për sa i përket organizatorit tjetër të këtij aktiviteti, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, lidhur me këtë veprimtari, institucioni nuk ka paraqitur prova dhe fakte mbi arsyet e mosraportimit të këtij aktiviteti. Për rrjedhojë, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarisë publike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit ka shkelur detyrimin ligjor duke mosraportuar veprimtarinë në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**5- Bashkia Poliçan**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, të regjistruara me **nr. 54, 55 ID**, për të cilat pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 54 ID**, *"Mes miqsh dhe dashamirës është zhvilluar ditën e sotme ceremonia e dhënies së titullit "Qytetar Nderi" i bashkisë Poliçan, z. Shkëlqim Beshiri. Ky vlerësim vjen pas një karriere të gjatë artistike si dhe kontributit të veçantë në promovimin e vlerave, traditave dhe këngës popullore të Njësisë Administrative Tërpan!*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=489878319989577&set=pcb.489878489989560>

- Denoncimi **nr. 55 ID**, *"Me përfaqësuesit e Sindikatës së punonjësve dhe ish-punonjësve të Kombinatit Mekanik në Poliçan në një takim për të dëgjuar shqetësimet e tyre dhe për të vlerësuar mundësinë e gjetjes së një zgjidhje të plotë.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=718771856269107&set=pcb.718754486270844>

Më datë 9.2.2023, bashkisë Poliçan i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike. Bashkia Poliçan nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion në asnjë moment.

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Poliçan, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 15.3.2023, por nuk pati përfaqësues për bashkinë Poliçan.

Për rrjedhojë, nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se bashkia Poliçan, nuk ka raportuar kryerjen e aktiviteteve objekt denoncimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Poliçan, përbën në shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.



**6- Bashkia Skrapar**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. **79 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **79 ID**, *"Ditën e sotme, datë 7 shkurt 2023, Bashkia Skrapar zhvilloi një takim informues, për projektin e fituar në kuadër të thirrjes EU4 for Municipalities, Ndërtimi i një Qendre Sportive, në shkollën 9 vjeçare "Zylyftar Veleshnja. Në takim morën pjesë, mësues dhe nxënës të shkollës 9 vjeçare "Zylyftar Veleshnja", përfaqësues nga komuniteti, si dhe përfaqësues të projektit BE për bashkitë".*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=207391448470372&set=pcb.207392148470302>

Më datë 24.2.2023 bashkisë Skrapar i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike por nuk i është përgjigjur këtyre kërkesave për informacion.

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Skrapar, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 15.3.2023, por nuk pati përfaqësues për bashkinë Skrapar.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, bashkia Skrapar, ka pasur detyrimin për raportim të aktiviteteve të mësipërme, por nuk e ka përmbushur këtë detyrim, duke shkelur kështu nenin 92 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

**7- Bashkia Roskovec**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. **88 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **88 ID** *"Mirmëngjes dhe me projektin "Ngritjen e kapaciteteve të grave dhe vajzave artizane" që ka për qëllim organizimin e grave dhe vajzave për t'u futur në tregun e punës e që shumë shpejt do të marrë jetë, ju urojmë një ditë të mbarë!"*

Prova link: <https://www.facebook.com/photo?fbid=574525961384736&set=pcb.574526064718059>

Më datë 27.2.2023 bashkisë Roskovec i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 1.3.2023, bashkia Roskovec ka bërë me dije se *"Ky aktivitet është zhvilluar në datën 9 shkurt, ditën e enjte, në orën 11:00 me pjesëmarrje të kryetares së bashkisë zj. Majlinda Bufi, Drejtorit të Kulturës dhe njësisë së integritit europian si edhe 25 gra, zonja banuese në bashkinë Roskovec. Ky aktivitet kishte në fokus ngritjen e kapaciteteve të grave dhe vajzave artizane te cilat realizojnë punime dore per te krijuar një ndermarrje sociale që do mbeshtesë këto gra..".*

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Roskovec, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 8.3.2023, por nuk pati përfaqësues për bashkinë Roskovec.

Në mbështetje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, veprimtari publike janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, në këto kushte aktiviteti i zhvilluar nga bashkia Roskovec përbën një veprimtari publike, referuar edhe karakteristikave të takimit, por edhe publikimit në median sociale "Facebook".

Për rrjedhojë, bashkia Roskovec në mbështetje të legjislationin në fuqi kishte detyrimin për raportim në ndërfaqen e krijuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda afateve të parashikuara. Nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit, rezultoi se bashkia Roskovec, nuk ka raportuar kryerjen e aktiviteteve objekt denoncimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Roskovec, përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të nenit 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

**8- Bashkia Lezhë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 6 (gjashtë) veprimtari publike, të regjistruara me nr. **15, 31, 96, 97, 121, 126 ID**, për të cilat pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **15 ID**, "*Bashkia Lezhë përkujton 555-vjetorin e vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu*".

Prova link:

<https://www.facebook.com/lezhebashkia/videos/6250924881606770>

Sipas denoncuesit veprimtara publike rezulton të jetë transmetuar në 1 (një) media publike.

- Denoncimi nr. **31 ID**, "*Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator. Denoncuesi pretendon si më poshtë vijon: "Nje takim sot me banorë të Lagjes SMT ku prej 30 vitesh mashtrohen duke i lënë me rrugë të shkatërruara! Bashkia Lezhë do bëjë sistemimin e rrugëve të brendshme duke marrë vlerësimin e banorëve për seriozitetin e punës tonë! Një bashkëbisedim me ta ku diskutuam disa problematika që duhen adresuar!"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=1858407264494781&set=pcb.1858408091161365>

- Denoncimi nr. **96 ID**, "*Një inspektim ne rrugën lidhëse ndërmjet rrugës "Dede Shabani dhe asaj "Azem Hajdari", ku bashkia Lezhë po bën rikualifikimin e rrugës dhe kanaleve kulluesel*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1867967100205464&set=pcb.1867967423538765>

- Denoncimi nr. **97 ID**, "*Vazhdojmë në terren aty ku kemi punët dhe ku marrim urimet dhe mbështetjen për ndryshimin e përditshëm! Inspektuam punimet e rrugës që fillon tek shkolla në Ishull Lezhë dhe që vazhdon nga Vila Veneto në thellësi të lagjes!*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1873011393034368&set=pcb.1873011869700987>

- Denoncimi nr. **121 ID**, "*Projekti "Dua të Luaj" që po zbatohet në qytetin e Lezhës do i sjellë qytetit një zonë me 3 fusha, tenis, basketboll dhe volejball, shatërvane, kënd lodrash për fëmijë, sipërfaqe të gjelbërt dhe zona atraktive ne breg të lumit Drin! Sot inspektuam punimet të cilat po ecin me ritmet e duhural Në Lezhë punohet kudo!"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1873751619627012&set=pcb.1873752159626958>

- Denoncimi nr. **126 ID**, "*Në Kallmet të lagjia "Gjatore" në bashkëbisedim me kryefamiljarë për problematika të ndryshme!"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1878918322443675&set=pcb.1878918565776984>

Bashkisë Lezhë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i është përgjigjur asnjë prej kërkesave për informacion për asnjë rast.

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Lezhë, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 8.3.2023, por nuk pati përfaqësues për bashkinë Lezhë.

Pasi u vlerësuan të gjitha aktivitetet e mësipërme, rezultoi se ato përbëjnë veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe si rrjedhojë, bashkia Lezhë ka pasur detyrimin për tu raportuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Lezhë, përbën në shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të nenit 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

**9- Bashkia Bulqizë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. **124 ID** për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 124 ID *"Sot, plot 75 vite nga krijimi zyrtarisht i minierës më të madhe të kromit në vend"*.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=566929382125750&set=pcb.566931095458912>

Më datë 27.2.2023 bashkisë Bulqizë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe jemi informuar me shkresën nr. 1071 prot., datë 28.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1249 prot., datë 2.3.2023, bashkia Bulqizë sqaron dhe bën me dije se *"Në aktivitetin e 75-vjetorit të krijimit të Minierës së Kromit Bulqizë organizuesi është bashkia Bulqizë. Aktiviteti u zhvillua tek Kinemaja ditën shtunën e 18.02.2023, ora 10:00. Pjesëmarrës në aktivitet ishin të ftuar të cilët kanë punuar dhe ato që po punonjë në miniera nga punëtorë të thjeshtë deri në drejtues, prani mediash të njoftuar nga ana jonë nuk kemi pasur në këtë aktivitet."*

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Bulqizë, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 15.3.2023, ku u deklarua nga përfaqësuesi se i përmbahet çfar është dërguar shkresërisht.

Pasi u vlerësua aktiviteti i mësipërm, rezultoi se veprimtaria përbën veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe si rrjedhojë, bashkia Bulqizë ka pasur detyrimin për tu raportuar. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Bulqizë, përbën në shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të nenit 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

**10- Bashkia Ebasan**, nuk ka raportuar për organizmin e 3 (tre) veprimtarive publike, të regjistruara me nr. **51, 52, 53 ID**, nga ku pretendohet si më poshtë:

- Denoncimi nr. **51 ID**, *"Bashkë me Gledin u ndalëm në ambientet e kësaj kompanie e pajisur me teknologji moderne, një fabrikë vërtet për t'u marrë shembull. Qeveria dhe bashkia e Elbasanit do vijojnë politikat mbështetëse ndaj sipërmarrjes përmes lehtësirave fiskale dhe çdo procedure për zgjerimin e biznesit."*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=725301385631916&set=pcb.725301945631860>

- Denoncimi nr. 52 ID, "Në fabrikën "M&M TOPUZI konstruksione metalike", lider në fushën e përpunimit të metaleve, një repart model me kualitet të lartë prodhimi sipas standarteve europiane."

Prova link:

<https://www.facebook.com/lilatja.gledian/videos/522558556528069/>

- Denoncimi nr. 53 ID, "Në ambientet e mobileri "Beta", një prej shumë sipërmarrjeve model në Elbasan, lider në përpunimin e durit që operon në treg me një gamë të gjerë produktesh prej vitit 1999. Qeveria do vijojë të jetë aleat i sipërmarrjeve të tilla duke u krijuar lehtësira fiskale që më pas përkthehen në injektim kapitali për ekonominë shqiptare, zgjerim të biznesit dhe vende pune për qytetarët."

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=724058725756182&set=pcb.724062892422432>

Nëpërmjet e-mail të datës 09.02.2023 me lëndë "Kërkesë për informacion" i është kërkuar bashkisë Elbasan, informacion sqarues në lidhje me denoncimin nr. 51, 52, 53 ID dhe nëpërmjet e-mail të datës 07.03.2023, jemi informuar nga se:

*"...nuk janë raportuar nga personi përgjegjës pasi nuk janë konsideruar veprimtari publike. Në referim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, dt. 24.12.2020, ky aktivitet nuk përbën veprimtari publike pasi zhvillohet në një biznes privat, vetëm në praninë e punonjësve që ndodheshin atë moment në ambientet e subjektit dhe pa praninë e mediave. Ky aktivitet nuk ka pasur në fokus të tij informimin e publikut në funksion të fushatës zgjedhore dhe në të nuk janë përdorur as thirrje politike dhe nuk kanë qenë prezent as punonjës të administratës publike. Këto tre veprimtari janë pasqyruar vetëm në faqen personale të rrjetit social të Kryetarit të Bashkisë dhe jo në faqen zyrtare apo në rrjetin social të Institucionit të Bashkisë."*

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Elbasan është njoftuar për zhvillimin e seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, më datë 15 Mars 2023. Në seancë nuk pati përfaqësues të këtij institucioni.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoi se aktivitetet e kryera nga z. Gledian Ilatja në praninë e drejtuesit politik të qarkut përbëjnë veprimtari publike në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor "formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre".

Neni 91, nuk e kufizon në një numër të caktuar se sa persona duhet të jenë të pranishëm për ta quajtur aktivitetin "publik". Pjesëmarrja e medias nuk është i vetmi element që e bën aktivitetin të konsiderohet si publik, por duhet të merren në konsideratë edhe element të tjerë, siç është numri i pjesëmarrësve në këto takime.

Të ndodhur në kushtet, që në bizneset ku z. Ilatja ka kryer takimet, ka pasur prezent punonjës, aktiviteti duhet të konsiderohet si "i hapur" për gjithë punonjësit që kanë qenë prezent në atë moment. Përsa më sipër, referuar nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, personi përgjegjës ka pasur detyrimin për raportim të aktiviteteve të mësipërme.



Referuar pjesëmarrjes së z. Gjijnuri në këto takime duhet sqaruar se pjesëmarrja e funksionarëve politike jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral. Fjalimi me përmbajtje elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Të ndodhur në kushtet e pamundësisë provuese, nëse gjatë takimeve të kryera nga z. Llatja dhe z. Gjijnuri kanë pasur thirrje elektorale, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se aktivitetet e mësipërme duhet të kategorizohet si aktivitete publike të paraportuara.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja "n", e 2, të nenit 21, pika 1, shkronja "dh", dhe nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012, "Për kundërvajtjet administrative", vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- a. Z. Armando Subashi, Kryetar në Bashkinë Fier, me gjobë në masën 10 (dhjetë mijë) lekë;
- b. Z. Nuri Belba, Kryetar në Bashkinë Prrenjas, me gjobë në masën 10 (dhjetë mijë) lekë;
- c. Z. Kastriot Gurra, Kryetar në Bashkinë Librazhd, me gjobë në masën 10 (dhjetë mijë) lekë;
- d. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
- e. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Poliçan, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
- f. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Skrapar, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
- g. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Roskovec, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
- h. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Lezhë, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
- i. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Bulqizë, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
- j. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Elbasan, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosjes së sanksioneve administrative, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendim nr. 200, date 24.12.2023, "Për shqyrtimin administrativ ndaj kryetarit të Bashkisë Fier, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Vendim nr. 201, date 24.12.2023, "Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Shkresa nr. 757, datë 10.02.2023, me lëndë "Kërkesë për informacion", drejtuar z. Armando Subashi";
- Shkresa nr. 757/1 prot., datë 20.02.2023, me lëndë "Kthim Përgjigje", të z. Armando Subashi;



- Shkresa nr. 758, datë 10.02.2023, me lëndë “Kërkesë për informacion”, drejtuar z. Armando Subashi;
- Shkresa nr. 758/1 prot., datë 20.02.2023, me lëndë “Kthim Përgjigje”, të z. Armando Subashi;
- E-mail i datë 27.02.2023, drejtuar z. Martin Dodi, si dhe kthimi i përgjigjes nëpërmjet e-mail të datës 02.03.2023;
- E-mail i datë 27.02.2023, drejtuar zj. Matilda Zerani, person përgjegjës për bashkinë Prrenjas, si dhe kthimi i përgjigjes nëpërmjet shkresës nr. 28.02.2023, të bashkisë Prrenjas;
- Shkresa nr. 436, datë 26.01.2023, me lëndë “Kërkesë për informacion”, drejtuar z. Kastriot Gurra, si dhe kthim i përgjigjes nëpërmjet shkresës nr. 436/1 prot., datë 02.02.2023, me lëndë “Kthim Përgjigje”, të Bashkisë Librazhd;
- E-mail i datës 14.02.2023, drejtuar z. Arian Korkuti, Prefekt i Qarkut Gjirokastrë, korrespondenca me palët në proces si dhe kthimi i përgjigjes së tyre;
- E-mail i datës 09.02.2023, drejtuar zj. Xhesjana Metollari, person përgjegjës për bashkinë Poliçan;
- E-mail i datës 24.02.2023, drejtuar zj. Rudina Llango, person përgjegjës për bashkinë Skrapar;
- E-mail i datës 27.02.2023, drejtuar zj. Delina Hoxha, person përgjegjës për bashkinë Roskovec si dhe kthimi përgjigjes nëpërmjet e-mail të datës 01.03.2023;
- E-mail i datës 16.02.2023, drejtuar zj. Xhesjana Metollari, person përgjegjës për bashkinë Lezhë;
- E-mail i datës 27.02.2023, drejtuar z. Leonard Daci, person përgjegjës për bashkinë Bulqizë, si dhe kthimi përgjigjes administruar me shkresën nr. 1249 prot., datë 02.03.2023;
- E-mail i datës 09.03.2023, drejtuar zj. Arjola Memeti, person përgjegjës për bashkinë Elbasan si dhe kthimi përgjigjes nëpërmjet e-mail të datës 07.03.2023.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

